



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

RELACION

PËR PROJEKTUDHËZIMIN “PËR CAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES DHE TRAJNIMIT TË SHETASVE QË MUND TË EMËROHEN KRYESISHT PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KOMISIONET E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR DHE KOMISIONET E QENDRAVE TË VOTIMIT”

Në përmbushje të kompetencës së parashikuar në nenin 20, paragrafi 1, germa “a” dhe “b”, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisionit Rregullator i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektudhëzimi “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Komisionet e Qendrave të Votimit”.

Kodi Zgjedhor në nenin 29, paragrafi 5, parashikon se procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht komisionerë zgjedhorë përcaktohen me udhëzim të veçantë nga KQZ.

KQZ ka plotësuar përbërjen e KZAZ-ve përmes emërimeve kryesisht të anëtarëve dhe të sekretarëve të KZAZ-ve në zgjedhjet vendore të vitit 2011. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor të vitit 2012 reflektuan praktikën e çelur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duke normuar emërimin kryesisht të anëtarëve të KZAZ-ve kur ishte rasti si edhe duke deleguar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të miratojë procedurat për përzgjedhjen dhe trajnimin e shtetasve që mund të emërohen kryesisht (neni 29, paragrafi 5, nënparagrafi i dytë).

Neni 29 i Kodit Zgjedhor, shprehet për emërimin “kryesisht” të anëtarëve të KZAZ-ve për plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje, dhe nuk shprehet për emërimin “kryesisht” të sekretarëve të KZAZ-ve. Në vlerësim të përcaktimeve ligjore për rolin dhe detyrat e anëtarit të KZAZ-së dhe sekretarit të KZAZ-së, ku anëtari ka të drejtë vote, dhe sekretari nuk ka të drejtë vote por ka detyra shumë të rëndësishme për krijimin, administrimin e dokumentacionit zgjedhor si dhe mbarëvajtjen e punës së KZAZ-së, detyra këto të detajuara në nenet 34 dhe vijues të Kodit Zgjedhor, asnjë anëtar i KZAZ-së nuk mund të kryejë detyrat e sekretarit të KZAZ-së.

Neni 29 i Kodit Zgjedhor, është një dispozitë që rregullon mbi ngritjen dhe funksionimin jo vetëm të administratës zgjedhore të nivelit të dytë, KZAZ, por edhe të administratës zgjedhore të nivelit të tretë, Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV). Kjo pasi Neni 29 është pazgjidhshmërisht i lidhur edhe me nenin 36 të Kodit Zgjedhor, i cili rregullon në lidhje me përbërjen e KQV. Sipas nenit 36, pika 1, “KQV-ja formohet sipas mënyrës dhe kriterëve të nenit 29 të këtij Kodi për çdo lloj zgjedhje...”.

Dispozitat vijuese të Kodit Zgjedhor, neni 36, paragrafi 5, parashikon të drejtën e KZAZ-së për plotësim kryesisht të vakancës në KQV, në rastet kur KQV mbetet pa kuorum me kalimin e afateve të parashikuara në paragrafin 4 të po këtij neni.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vitin 2013, ka miratuar Udhëzimin Nr.4, datë 19.02.2013 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV”, duke reflektuar praktikën zgjedhore dhe delegimin ligjor në këtë drejtim. Ky



akt normativ i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka parashikuar rregullin për emërimin “kryesisht” edhe të sekretarëve të KZAZ-së, po ashtu edhe të anëtarëve dhe sekretarëve të KQV, për plotësim të vakancave të shkaktuara nga mosparaqitja e propozimeve nga partitë politike. Rregullimi përmes aktit normativ, edhe për pozicionet e sekretarëve të KZAZ, po ashtu edhe të anëtarëve dhe sekretarëve të KQV-ve, megjithëse pa autorizim të shprehur nga ligji, por si ushtrim diskrecional autoriteti në frymën e Kodit Zgjedhor, i zbatuar në zgjedhjet e vitit 2017 dhe në zgjedhjet e vitit 2019, tashmë është një praktikë e konsoliduar.

Projektudhëzimi i paraqitur, në zbatim të frymës dhe normave të Kodit Zgjedhor, por edhe të në referim “Garancive procedurale” të Kodit të Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, ka për qëllim detajimin e procedurave për emërimet kryesisht, si në rastet kur ato zbatohen nga KQZ apo nga KZAZ, në funksion të sigurisë dhe rritjes së transparencës për kryerjen e procedurave të përzgjedhjes së shtetasve për emërim kryesisht.

Neni 1, reflekton qëllimin dhe objektin e projektudhëzimit.

Neni 2, reflekton të drejtat dhe detyrat e anëtarit dhe të sekretarit të emëruar kryesisht në përbërje të KZAZ-së apo të KQV-së.

Neni 3, reflekton kushtet që duhet të plotësojnë shtetasit për emërim kryesisht anëtar dhe sekretar i KZAZ-së. Ky nen është një transpozim korrekt i nenit 31 të Kodit Zgjedhor, duke u plotësuar me shkronjën “dh” e cila parashikon kushtin që shtetasi të mos ketë qënë anëtar i strukturave drejtuese të ndonjë partie politike tre vitet e fundit. Parashikimi i këtij kushti synon të shmangë paragjykime të mundshme, si dhe të mos cënojë besimin në administrimin korrekt të procesit, edhe në rastet kur në strukturat zgjedhore nuk realizohet barazpeshimi politik i përbërjes së tyre.

Neni 4, një transpozim korrekt i nenit 30 të Kodit Zgjedhor reflekton papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe sekretarit të KZAZ.

Neni 5, përcakton procedurat për njoftimin publik të kërkesës për shprehje interesi për emërim kryesisht, dokumentacionin që duhet të paraqesin shtetasit për të vërtetuar përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të kërkura, si edhe afatin për paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit. Për të vërtetuar nivelin e arsimit, përcaktohet paraqitja e kopjes së diplomës, duke marrë përgjegjësinë e deklaramit të vërtetësisë së saj përmes një deklarate të nënshkruar. Afati 20 ditor nga njoftimi publik për shprehje interesi, deri në afatin fundor për dorëzimin e dokumentacionit, thjeshtësimi i kërkesave për mënyrën e paraqitjes së dokumentacionit, synojnë të shtojnë interesin/numrin e shtetasve që paraqesin kërkesë për emërim kryesisht në përbërje të KZAZ-ve.

Neni 6, parashikon procedurat dhe afatet për kryerjen nga administrata e KQZ të verifikimeve të kërkesave dhe dokumentacionit të shtetasve, dhe të miratimit nga Komisioneri të listës së shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht në përbërje të KZAZ-ve për plotësim të vakancave.

Neni 7, përcakton procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve apo sekretarëve të KZAZ-ve, që do të emërohen kryesisht nga Komisioneri për plotësim të vakancave në KZAZ. Procedurat parashikojnë dy situata:

1. kur numri i shtetasve në listë është sa numri i vakancave në KZAZ-të e zonës zgjedhore;
2. kur numri i shtetasve është më më i madh se numri i vakancave në KZAZ-



të e zonës zgjedhore. Në këtë rast përzgjedhja do të bëhet mbi bazë shorti. Për zonat zgjedhore, të cilat janë të ndara në disa në disa KZAZ, dhe ka vakanca të pozicionit të anëtarit dhe sekretarit, së pari do të hidhet shorti për përzgjedhjen e shtetasve që do të emërohen kryesisht si sekretar dhe më pas do të hidhet shorti për përzgjedhjen e shtetasve që do të emërohen kryesisht si anëtar. Ky rend përcaktohet me qëllim që shtetasit me arsim juridik, të cilët marrin pjesë në shortin e parë por nuk përzgjidhen, të bëhen pjesë edhe në shortin e dytë që hidhet për anëtar të KZAZ.

Shtetasit që do të përzgjidhen dhe emërohen nga Komisioneri kryesisht për plotësim të vakancave në KZAZ, janë të detyruar të paraqesin në KQZ kopje të noteruar të diplomës së arsimit të lartë.

Neni 8, reflekton kushtet që duhet të plotësojnë shtetasit për emërim kryesisht anëtar dhe sekretar të KQV-së. Ky nen është një transpozim korrekt i nenit 38 të Kodit Zgjedhor, duke u plotësuar me shkronjën “dh” e cila parashikon kushtin që shtetasi të mos ketë qënë anëtar i strukturave drejtuese të ndonjë partie politike tre vitet e fundit. Parashikimi i këtij kushti, sikundër në parashimimet për KZAZ, synon të shmangë paragjyqime të mundshme, si dhe të mos çenojë besimin në administrimin korrekt të procesit, edhe në rastet kur në strukturat zgjedhore nuk realizohet barazpeshimi politik i përbërjes së tyre.

Neni 9, një transpozim korrekt i nenit 37 të Kodit Zgjedhor reflekton papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe sekretarit të KQV.

Neni 10, përcakton procedurat për njoftimin publik të kërkesës për shprehje interesi për emërim kryesisht, dokumentacionin që duhet të paraqesin shtetasit për të vërtetuar përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të kërkuara, si edhe afatin për paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit. Për të vërtetuar nivelin e arsimit, përcaktohet paraqitja e kopjes së diplomës, duke marrë përgjegjësinë e deklaramit të vërtetësisë së saj përmes një deklarate të nënshkruar. Afati 30 ditor nga njoftimi publik për shprehje interesi, deri në afatin fundor për dorëzimin e dokumentacionit, thjeshtësimi i kërkesave për mënyrën e paraqitjes së dokumentacionit, synojnë të shtojnë interesin/numrin e shtetasve që paraqesin kërkesë për emërim kryesisht në përbërje të KQV-ve.

Paraqitja në KQZ, jo në KZAZ, shqyrtimi po prej KQZ i kërkesave për shprehje interesi për emërim kryesisht në përbërje të KQV, ka për qëllim mbikqyrjen dhe kontrollin në nivelin më të lartë të administratës zgjedhore, përbërjes dhe mënyrës së funksionimit së saj, në përputhje të plotë me misionin dhe detyrat e KQZ.

Neni 11, parashikon procedurat dhe afatet për kryerjen nga administrata e KQZ të verifikimeve të kërkesave dhe dokumentacionit të shtetasve, dhe të miratimit nga Komisioneri të listës së shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht nga KZAZ në përbërje të KQV-ve për plotësim të vakancave.

Neni 12, përcakton procedurat që do të zbatojë KZAZ për përzgjedhjen dhe emërimin kryesisht të anëtarëve apo sekretarëve të KQV-ve, për plotësim të vakancave. Procedurat parashikojnë dy situata:

1. kur numri i shtetasve në listë është sa numri i vakancave në KQV-të në juridiksion territorial të Zonës së Administrimit Zgjedhor;
2. kur numri i shtetasve është më i madh se numri i vakancave në KQV-të Zonës së Administrimit Zgjedhor. Në këtë rast KZAZ do të përzgjedhë do të bëhet mbi bazë shorti. Për zonat zgjedhore, të cilat janë të ndara në disa në disa KZAZ, dhe ka vakanca të pozicionit të anëtarit dhe sekretarit, së pari do të hidhet



shorti për përzgjedhjen e shtetasve që do të emërohen kryesisht si sekretar dhe më pas do të hidhet shorti për përzgjedhjen e shtetasve që do të emërohen kryesisht si anëtar. Ky rend përcaktohet me qëllim që shtetasit me arsim juridik, të cilët marrin pjesë në shortin e parë por nuk përzgjidhen, të bëhen pjesë edhe në shortin e dytë që hidhet për anëtar të KZAZ.

Shtetasit që do të përzgjidhen dhe emërohen nga KZAZ kryesisht për plotësim të vakancave në KQV, janë të detyruar të paraqesin në KQZ kopje të noteruar të diplomës së arsimit të lartë.

Neni 13, përcakton rregullat për trajnimin e shtetasve që emërohen kryesisht në përbërje të KZAZ dhe KQV.

Neni 14 dhe neni 15 parashikojnë shfuqizimin e Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV” i ndryshuar, hyrjen në fuqi të Udhëzimit, dhe detyrimin e publikimit të tij në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ana TENOLLI – Drejtorja e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore
Madalena KOJA – Drejtorja Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor
Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm

